



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0045109-2/27 dt. 10.07.2024
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin për Bujqësinë, nenin 1, paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Rregullores Komunale Nr. 05/2012 për Mënyrën e Organizimit të Korrje Shrijeve, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0045109/24, dt. 05.07.2024 të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M


(Për formimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Korrjeve – Shirjeve të Drithërave të Bardha në Komunën e Mitrovicës së Jugut për Vitin 2024)

1. **Formohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Korrjeve – Shirjeve të Drithërave të Bardha në Komunën e Mitrovicës së Jugut për Vitin 2024, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Bedri Bajrami – kryetar, (DBZHR);
 - 1.2 Jeton Bajrami – anëtar, (DBZHR);
 - 1.3 Irfan Peci – anëtar, (DMMP);
 - 1.4 Agron Sylejmani – anëtar, (DI);
 - 1.5 Besim Beka – anëtar, (DSE).
2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë mbikëqyrjen e të gjitha korrjeve – shirjeve të Drithërave të Bardha që do të bëhen në Komunën e Mitrovicës së Jugut gjatë vitit 2024, dhe të bëjë kontrollimin teknik dhe monitorimin e autokumbanjave gjatë korrjeve - shirjeve, dhe për mbarëvajtjen e këtij procesi të hartojë Raport me Shkrim dhe të njëjtin t'ia prezantojë Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
3. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Rregulloren Komunale Nr. 05/2012 për Mënyrën e Organizimit të Korrje - Shirjeve, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
4. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundim të procesit të korrjeve – shirjeve.



5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës



Bedri HAMZA

Shtojcë:

Propozim – Vendimi Nr. 01-020/04-0045109/24, dt. 05.07.2024 i DBZHR-së.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit